



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____

MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPEVE VENDORE TË VEPRIMIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

NENI 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e parakushteve për krijimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit të cilët do të mundësojnë, përmes partneritetit lokal dhe metodës nga poshtë-lart përfshirjen e komuniteteve lokale në identifikimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të udhëhequra nga vetë komuniteti në varësi të nevojave të tyre, marrjen e vendimeve për alokimin e burimeve të tyre financiare, dhe menaxhimin e tyre bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, krijimi, sigurimi i një mjedisi për investimet në zonat rurale nga vetë komuniteti si dhe ngritja e kapaciteteve vendore.

NENI 2

Fusha e veprimit

Ky ligj përcakton parimet bazë, kriteret, përgjegjësitë, dhe proceset për organizimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit, hartimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të udhëhequra nga komuniteti, në harmoni me Politikën e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural.

NENI 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- a. **“Autoritet menaxhues”** është institucioni përgjegjës për programimin dhe zbatimin e programit operacional të zhvillimit bujqësor dhe rural;
- b. **“Agjencia e pagesave”** është institucioni përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollimin e shpenzimeve të masave të financuara nga Programi i Zhvillimit Bujqësor dhe Rural.
- c. **“Aktivitete në Rrjet”** do të thotë shkëmbim arritjesh, përvojash dhe ekspertizash ndërmjet aktorëve ruralë, mundësuar nga LEADER;
- d. **“Autoritet Publik”** do të thotë:
 - i. Institucione të qeverisjes qendrore ose vendore ose institucione të tjera të administratës publike, përfshi organe publike këshilluese në nivel kombëtar, rajonal ose lokal.
 - ii. çdo person fizik ose juridik që kryen funksione administrative publike, përfshi detyra, aktivitete apo shërbime të veçanta në lidhje me zhvillimin rajonal; dhe
 - iii. çdo person fizik apo juridik që ka përgjegjësi apo funksione publike, ose që ofron shërbime publike në lidhje me zhvillimin rajonal nën kontrollin e një organi apo personi që i përket (i) apo (ii).
- e. **“Grup Vendor i Veprimit”** është një organizatë jo fitimprurëse me bazë partneriteti e përbërë nga përfaqësues të interesave lokale socio-ekonomike publike dhe private, në të

cilën, në nivelin e vendimmarrjes asnjë autoritet publik ose grup interesi nuk përfaqëson më shumë se 49% të të drejtave të votës;

- f. **“Kosto Operative”** janë kostot e lidhura me menaxhimin e zbatimit të Strategjisë së zhvillimit lokal e udhëhequr nga komuniteti, që kanë të bëjnë me kosto funksionimi, paga personeli, kosto trajnimesh, kosto për veprimtarinë mbi marrëdhëniet me publikun, kosto financiare si dhe kosto të lidhura me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë;
- g. **“LEADER”** është metoda e veçantë e krijuar nga Komuniteti European në vitin 1991 për t’u ofruar komuniteteve rurale në BE një metodë për përfshirjen e partnerëve vendorë në drejtimin e zhvillimit të ardhshëm të zonave rurale, mobilizimin dhe arritje të zhvillimit territorial në komunitetet rurale lokale në përputhje me këto kritere: e fokusuar në zona të veçanta nën-rajonale; e udhëhequr nga grupe lokale të veprimit të përbërë nga përfaqësues të interesave lokale socio-ekonomike publike dhe private; e kryer përmes strategjive të zhvillimit lokal të integruara dhe shumë-sektoriale të bazuara në zona; e përshtatur për të marrë në konsideratë nevoja dhe potenciale lokale; dhe që përfshin karakteristika inovative në kontekst, rrjet dhe kur është e përshtatshme bashkëpunim lokal;
- h. **“Marrëveshje Partneriteti Lokal”** është një marrëveshje e shkruar e firmosur nga një grup përfaqësuesish të interesave publike dhe private socio-ekonomike të të njëjtës zonë rurale nën-rajonale, me qëllim promovimin e themelimit dhe akreditimin e një GVV-je.
- i. **“Ministri”** do të thotë Ministria përgjegjëse për politikën e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural;
- j. **“Ministër”** do të thotë Ministri përgjegjës për politikën e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural;
- k. **“Politika Kombëtare e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”** është perspektiva afat-gjatë dhe zbatimi i drejtimeve kryesore të zhvillimit bujqësor dhe rural të vendit dhe të zonave të tij bujqësore individuale, në koordinim mes autoriteteve publike qendrore dhe lokale, që synon planifikimin dhe zbatimin e një zhvillimi të ekuilibruar socio-ekonomik bujqësor dhe rural;
- l. **“Program Zhvillimi Bujqësor dhe Rural”** është programi operacional kombëtar që mbështet zhvillimin bujqësor dhe rural duke zbatuar politikën kombëtare të zhvillimit bujqësor dhe rural;
- m. **“Projekt bashkëpunimi”** do të thotë një projekt i përbashkët ndërmjet dy ose më shumë GVV në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, dhe në rastin e dytë partneri i huaj mund të jetë një GVV ose një grup i ngjashëm me GVV. Projektet e bashkëpunimit përfshijnë veprime konkrete të zbatuara bashkërisht me pritshmëri të identifikuar qartë që sjellin përfitime për secilin nga territoret e përfshira;
- n. **“Publik”** do të thotë një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, shoqatat, organizatat ose grupimet e tyre;
- o. **“Strategji e zhvillimit lokal e udhëhequr nga komuniteti”** është tërësia e masave koherente të hartuara dhe zbatuara nga një GVV, qëllimi i së cilës është të plotësojë objektivat dhe nevojat lokale dhe që kontribuon në arritjen e objektivave të politikës kombëtare të zhvillimit bujqësor dhe rural;
- p. **“Vitalizimi Lokal”** është procesi/aktiviteti që mbështet apo promovon takimet dhe dialogun ndërmjet banorëve, konvergjencën ndërmjet sektorëve, shkëmbimin e njohurive dhe plotësueshmërinë e aftësive, aspekte të cilat “vitalizimi” synon ti ndërtojë ndërmjet një shumëllojshmërie grupesh interesi të përfshira apo që mund të përfshihen në GVV;

- q. **“Zona LEADER”** është një zonë rurale nën-rajonale që përcakton kufijtë brenda të cilëve hartohet dhe zbatohet një strategji e veçantë e zhvillimit lokal e udhëhequr nga komuniteti.

NENI 4

Parimi i Partneritetit

1. GVV është shprehje e një partneriteti lokal të gjerë dhe përfaqësues. Për këtë arsye, një GVV në çdo rast përfshin të paktën tipologjitë e mëposhtme të partnerëve që operojnë brenda kufijve të Zonës LEADER siç parashikohet në ligj:
 - a. Të gjitha njësitë e vetë-qeverisjes vendore dhe institucione të tjera publike, të tilla si: bashkia/bashkitë ose qarku në territorin e të cilës shtrihet zona LEADER, institucionet e dekoncentruara në nivel lokal dhe rajonal, agjenci rajonale, apo degë të enteve publike kombëtare, etj.;
 - b. Përfaqësuesit përkatës të sektorit privat fermer dhe jo fermer, sipërmarrje fermere dhe jo-fermere në nivel individual dhe/ose shoqate, organizata dhe unione profesionale që përfaqësojnë fermerët, profesionistët jo fermerë dhe mikro-sipërmarrjet, dhe shoqatat tregtare;
 - c. Organizata që përfaqësojnë shoqërinë civile, organizatat e banorëve, shoqatat ambientaliste, shoqatat e grave dhe të rinjve, ofruesit e shërbimeve kulturore dhe komunitare si mediat, organizata të tjera jofitimprurëse, dhe organet përgjegjëse për promovimin e përfshirjes sociale, barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit.
2. Asnjë autoritet publik ose grup interesi (nga sektori privat ose shoqëria civile) nuk mund të përfaqësojë më shumë se 49% të të drejtave të votës në nivelin më të lartë të vendimmarrjes së GVV sipas ligjit.
3. Pa rënë ndesh me paragrafin 2 të këtij neni, GVV do të miratojë rregulla të veçanta, procedura dhe rregullimet e tjera për ta mbajtur partneritetin të hapur dhe për të inkurajuar zgjerimin e tij me partnerë të rinj lokalë.

NENI 5

Parimi Territorial

1. Zona LEADER duhet të ketë qartësisht të dallueshëm dhe qëndrueshëm koherencën fizike/territoriale, sociale dhe ekonomike, dhe në të njëjtën kohë duhet të ketë mjaftueshëm “masë kritike” sipas këtij neni, për të arritur objektivat e saj.
2. Aktorët lokalë, sipas nenit 4 të këtij ligji, mund të themelojnë një GVV vetëm në një zonë LEADER duke përcaktuar kufijtë më të përshtatshëm për të arritur objektivat e tyre.

3. Kufijtë e zonës LEADER sipas këtij neni duhet të plotësojnë këto kritere: të jenë të vazhdueshëm gjeografikisht; të mbulojnë një territor rural me popullsi jo më pak se 10,000 dhe jo më shumë se 150,000 banorë.
4. Kriteret e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni mund të anashkalohen në raste të justifikuara, bazuar në legjislacionin në fuqi, sipas parashikimeve të nenin 14 të këtij Ligji.
5. Kufijtë administrativë të bashkisë, sipas përcaktimit të ligjit nr. 115/2014 “Mbi ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, nuk kanë rol kufizues në përcaktimin e kufijve të zonës LEADER.

NENI 6

Parimi nga Poshtë-Lart

Metoda nga poshtë-lart do të thotë që aktorët lokalë marrin pjesë në vendimmarrjen mbi strategjinë dhe prioritetet e zgjedhura që do të ndiqen në zonën e tyre.

1. Përfshirja e aktorëve lokalë do të thotë që përfshihet edhe popullsia në një masë të madhe, grupet e interesave ekonomike dhe sociale, dhe përfaqësuesit e institucioneve publike dhe private.
2. Për të aplikuar parimin nga poshtë-lart, GVV do të përfshijnë aktorët lokalë në përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e Strategjive të Zhvillimit Lokal të Udhëhequra nga Komuniteti, dhe në mënyrë të veçantë lidhur me:
 - a. analizimin dhe identifikimin e nevojave;
 - b. përcaktimin e objektivave të përgjithshme dhe specifike;
 - c. përcaktimin e prioriteteve përkatëse të zgjedhura
 - d. alokimin e fondeve;
 - e. zbatimin e strategjisë;
 - f. monitorimin dhe vlerësimin e progresit të zbatimit të strategjisë.

NENI 7

Parimi i Rrjetëzimit dhe Bashkëpunimit

Me qëllim tejkalimin e izolimit të zonave rurale dhe fuqizimin e kapaciteteve të aktorëve lokalë të zonave LEADER për të ndjekur objektivat e tyre zhvilluese përmes shkëmbimeve të dijeve dhe eksperiencave si dhe bashkëpunimit konkret me territore të tjera, transferimi i praktikave dhe përhapja e risive të GVV-ve do të lejohen dhe inkurajohen të promovojnë aktivitetet në rrjet dhe projektet e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GVV

NENI 8

Fusha e veprimit të GVV

1. Fusha e veprimit të GVV-ve është mbështetja e rritjes ekonomike, sociale dhe kulturore të komuniteteve të zonës LEADER, përmes rritjes së vlerave të burimeve lokale dhe aseteve, përmes hartimit dhe zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Lokal të Udhëhequr nga Komuniteti.
2. Për këtë qëllim, GVV mund të promovojë lloje të ndryshme aktiviteteve, të tilla si:
 - a. pjesëmarrjen në iniciativa rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare për financimin e iniciativave të qëndrueshme;
 - b. pjesëmarrjen në rrjete kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqata apo institucione, veprimtaria e të cilave ndjek objektiva të ngjashme;
 - c. Promovimin e iniciativave të komunikimit, bashkëpunimit në rrjet dhe projekteve të bashkëpunimit që kanë si qëllim promovimin e marrëdhënieve fitimprurëse ndërmjet aktorëve lokalë, me territore të tjera dhe institucione të tjera.
 - d. ofrimin e informacioneve, mbështetjes teknike dhe trajnimit të promotorëve lokalë potencialë të projekteve;
 - e. administrimin dhe menaxhimin e aseteve.

NENI 9

Struktura e GVV

1. GVV krijohen dhe funksionojnë si organizata jo-fitimprurëse me anëtarësi, siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 10 të ligjit 8788/2001 “Mbi organizatat jo-fitimprurëse”, i ndryshuar.
2. Në respektim të dispozitave dhe kërkesave të tjera të këtij ligji, në mënyrë të veçantë barazinë gjinore në strukturat e saj, një GVV akreditohet dhe regjistrohet vetëm nëse struktura e tij organizative ka të paktën këto struktura të brendshme:
 - a. Asamblenë e Përgjithshme;
 - b. Presidentin;
 - c. Bordin Ekzekutiv;
 - d. Stafin, që do të përfshijë të paktën:
 - i. Drejtorin Ekzekutiv;
 - ii. Kontabilistin (që mund të jetë ekspert i jashtëm);
3. Asambleja e Përgjithshme e GVV është organi më i lartë vendimmarrës në të cilin të gjithë anëtarët e GVV ftohen në mbledhje të paktën një herë në vit, dhe është përgjegjëse për zgjedhjen e Bordit dhe Presidentit nga radhët e anëtarëve të GVV. Këto zgjedhje duhet të ndjekin parimin e partneritetit si edhe barazinë territoriale, gjinore dhe të moshës.
4. Funkcionet e Asamblesë së Përgjithshme përcaktohen në statutin e GVV, duke respektuar dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

5. Bordi i GVV është organi më i lartë ekzekutiv ku përfaqësohen të gjithë partnerët e zonës LEADER, të propozuar nga secila tipologji partnerësh sipas parimit të partneritetit sipas përcaktimit të nenit 4 të këtij ligji.
6. Bordi i GVV është përgjegjës për vendimmarrjen e përditshme të GVV dhe për funksionimin ligjor dhe financiar të tij, gjithashtu përgjegjës për autorizimin e kostove operative të cilat në çdo rast nuk mund të kalojnë 25% të shpenzimeve të fondeve publike të kryera në kuadër të strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti.
7. Presidenti i GVV udhëheq mbledhjet e Bordit. Të gjithë anëtarët e Bordit duhet të firmosin një deklaratë konfidencialiteti në lidhje me informacionet me të cilat njihen në pozicionet e tyre përmes procesit të vendimmarrjes.
8. Bordi mund të emërojë nën-komitete për të përgatitur dhe vlerësuar materialet që do të paraqiten për vendimmarrjen e Bordit, të tilla si: nën-komitete bashkëpunimi, vlerësimi dhe monitorim projektsh.
9. Stafi i GVV mund të përfshijë këshilltarë/koordinatorë projektsh, këshilltarë/koordinatorë komuniteti, këshilltarë/koordinatorë biznesi, asistentë zyre, etj., nëse konsiderohet e nevojshme.

NENI 10

Funksionet e GVV

1. Grupi Vendor i Veprimit i akredituar dhe regjistruar sipas përcaktimit të kreut III të këtij ligji, harton dhe/ose miraton mundësisht brenda 1 viti nga fillimi i funksionimi të tij strategjinë e zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti për zonën LEADER që mbulon.
2. Strategjia e zhvillimit lokal e udhëhequr nga komuniteti miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e GVV, vetëm pasi vërtetohet se përmban të paktën këto elementë:
 - a. Numrin e banorëve dhe përkufizimin e zonës për të cilën ajo zbatohet;
 - b. Analizën e nevojave të zhvillimit dhe potencialin konkurrues të zonës, përfshirë analizën e aspekteve të forta, dobësive, mundësive dhe risqeve në zhvillimin e zonës;
 - c. Përshkrimin e strategjisë dhe objektivave të saj, përshkrimin e karakteristikave inovative dhe të integruara të saj, si dhe rezultate dhe produkte të matshme të shprehura në njësi matëse sasiore apo cilësore;
 - d. Përshkrimin e procesit gjithëpërfshirës të komunitetit të Zonës LEADER, gjatë përgatitjes së saj;
 - e. Planin e veprimit që përcakton veprimet konkrete që zbatohen për realizimin e objektivave të saj;
 - f. Përshkrimin e rregullave të menaxhimit dhe monitorimit të strategjisë, aftësinë e strukturës së GVV për të zbatuar strategjinë, si dhe përshkrimin e rregullave të detajuara për vlerësimin e zbatimit të saj;
 - g. Planin financiar për zbatimin e strategjisë si dhe burimet e financimit të tij.
3. Gjatë zbatimit të strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti, GVV duhet të jetë në gjendje të kryejnë funksionet e mëposhtme:

- a. të krijojë kapacitetet e aktorëve lokalë për të zhvilluar dhe zbatuar masa/aktivitete që përfshijnë fuqizimin e kapaciteteve të tyre të menaxhimit të projekteve;
 - b. të hartojë një procedurë seleksionimi jo-diskriminuese dhe transparente dhe të përcaktojë kritere objektive për përzgjedhjen e projekteve, të cilat shmangin konfliktet e interesit dhe që sigurojnë të paktën 50% të votave në vendimet për seleksionim/përzgjedhje të partnerëve që nuk janë autoritete publike, dhe lejojnë përzgjedhje në bazë të procedurave të shkruara;
 - c. të sigurojë koherencë me strategjinë e zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti kur përzgjedh projektet, duke i prioritetizuar projektet në bazë të kontributit që ato japin në arritjen e objektivave të asaj strategjie;
 - d. të përgatisë dhe publikojë kërkesa për propozime ose një procedurë të vazhdueshme të paraqitjes së projekteve, përfshi përcaktimin e kritereve të përzgjedhjes;
 - e. të marrë dhe vlerësojë aplikimet për mbështetje;
 - f. të përzgjedhë projektet dhe të përcaktojë masën e mbështetjes dhe kur është e zbatueshme të paraqesë propozime te organi përgjegjës për verifikimin final të të drejtave, para aprovimit;
 - g. të monitorojë dhe zbatojë strategji të zhvillimit lokal të udhëhequra nga komuniteti dhe projektet e mbështetura përkatësisht dhe të kryejë aktivitete specifike vlerësimi që lidhen me atë strategji;
 - h. të vitalizojë strategjinë e zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti për të mundësuar shkëmbime mes aktorëve për sigurimin e informacionit dhe promovimin e strategjisë, dhe të mbështesë përfituesit potencialë duke synuar zhvillimin e projekteve dhe përgatitjen e aplikimeve.
4. Gjatë zbatimit të strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti, GVV duhet të ketë burime njerëzore të përshtatshme dhe kompetente sidomos për funksionet e mëposhtme:
- a. vitalizimin lokal;
 - b. menaxhimin administrativ dhe financiar;
 - c. sisteme të zbatimit dhe realizimit të objektivave të strategjisë.

NENI 11

Organizimi i GVV

1. Gjatë realizimit të misionit të tij publik, aktivitetet e GVV kryhen në përputhje me parimet e një prokurimi publik efektiv, transparent dhe llogaridhënës dhe me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, siç përcaktohet në ligjin Nr. 10296/2010 “Mbi menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.
2. Pa rënë ndesh me kërkesat e Ligjit Nr. 10296/2010, Asambleja e Përgjithshme e GVV duhet të aprovojë një rregullore të brendshme që përcakton procedurat me të cilat GVV funksionon, me qëllim garantimin e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e vendimmarrjes dhe në

menaxhimin teknik dhe administrativ të aktiviteteve. Rregullorja e Brendshme duhet të rregullojë të paktën këto çështje:

- a. Aplikimin e parimit të partneritetit;
- b. Aplikimin e parimit nga poshtë-lart;
- c. Aplikimin e parimit të rrjetëzimit dhe bashkëpunimit;
- d. Organizimin e strukturës operacionale (stafit);
- e. Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- f. Prokurimin e mallrave dhe shërbimeve;
- g. Hartimin dhe zbatimin e strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti;
- h. Konfliktin e interesit.

NENI 12

Instrumentet Financiare

1. Instrumentet financiare për financimin e GVV miratohen nga Asambleja e Përgjithshme, siç përcaktohet në strategjinë e zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti në zonën e dhënë LEADER, bazuar në kritere të tilla si tipologjia e masave të zgjedhura dhe aftësia për të garantuar sukses ekonomik dhe social.
2. Instrumentet e financimit përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - a. Tarifën e Anëtarësimit
 - b. Grante nga programi IPARD;
 - c. Grante nga programe të tjera publike qendrore apo vendore;
 - d. Kredi;
 - e. Skema garancie;
 - f. Pjesëmarrje me aksione (në para/në natyrë);
 - g. Partneritete Publik-Privat;
3. Njësitë e vetë-qeverisjes vendore pjesëmarrëse në një GVV të regjistruar dhe akredituar siç përcaktohet në këtë ligj, financojnë të paktën 50% të kostove operacionale të GVV të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, pavarësisht nga përqindja në fuqinë vendimmarrëse të saj brenda GVV-së.
4. Në rastet kur në një GVV merr pjesë më shumë se një njësi e vetë-qeverisjes vendore, përqindja e financimit të tyre në GVV, vendoset në raport me përqindjen e territorit të secilës njësi të vetë-qeverisjes vendore kundrejt territorit të zonës LEADER.

NENI 13

Konflikti i interesit

1. Konflikt interesi është një situatë që ka potencialin të çënojë paanësinë për shkak të konfliktit të mundshëm ndërmjet interesave individuale, kolektive, profesionale ose publike.

2. Seksioni i rregullores së brendshme të GVV mbi konfliktin e interesit duhet të adresojë këto kritere:
 - a. Anëtarët e Bordit të GVV që kanë interes direkt ose indirekt, ose përfaqësues të subjekteve që kanë interes direkt në një projekt të përcaktuar, nuk mund të jenë pjesëmarrës në vendimmarrjen mbi çështjen. Në këtë rast anëtarëve që janë palë të interesuara do u kërkohet të largohen nga mbledhja në të cilën do të merret vendimi. Proces-verbali i mbledhjes së Bordit duhet të raportojë daljen e anëtarëve dhe arsyet përkatëse;
 - b. Punonjësit e GVV nuk duhet të kryejnë aktivitete të tjera ekonomike që paraqesin konflikt interesi, veçanërisht në lidhje me marrëdhëniet me përfituesit;
 - c. Punonjës dhe konsulentë të jashtëm që koordinojnë vitalizimin e një territori dhe/ose që janë përgjegjës për menaxhimin dhe koordinimin administrativ të GVV, nuk mund të jenë përfitues direkt të ndërhyrjeve të mbështetura nga GVV;
 - d. Punonjës dhe konsulentë të jashtëm që janë të afërm deri në shkallë të dytë të një individi aplikues për mbështetje ose një menaxheri apo përfaqësuesi të një organizate që aplikon për financim nuk mund:
 - i. të marrin pjesë në procesin vendimmarrës të GVV;
 - ii. të shqyrtojnë aplikimin e atij aplikuesi;
 - iii. të përfshihen në monitorimin ose vlerësimin e aktiviteteve që lidhen me aplikuesin.
 - e. Punonjës përgjegjës për menaxhimin, dhe të afërm të tyre deri në shkallë të dytë, nuk mund të jenë ofrues mallrash ose shërbimesh ndaj GVV ose përfituesve publikë ose privatë të GVV.

KREU III AKREDITIMI I GVV

NENI 14 Procedurat e Akreditimit

1. GVV-të duhet të plotësojnë kriteret e akreditimit që të mund të ushtrojnë funksionet e tyre sipas këtij ligji.
2. Kriteret dhe procedurat e detajuara për akreditimin e GVV-ve, sipas paragrafit 1 të këtij neni, propozohen nga Ministri dhe miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe duhet të përfshijnë të paktën:
 - a. Respektimin e zonës LEADER ku funksionon GVV;
 - b. Kërkesat mbi strukturën operacionale të GVV;
 - c. Respektimin e Statutit dhe Aktit të Themelimit të GVV;
 - d. Respektimin e rregullores së brendshme të GVV - menaxhimin e riskut;
 - e. Informacionin dhe komunikimin;
 - f. Monitorimin e kuadrit të auditit të brendshëm.

3. Ministri cakton me urdhër strukturën e ministrisë që do të jetë përgjegjëse për akreditimin dhe regjistrimin e GVV-ve.

NENI 15 **Regjistri i GVV**

1. Struktura përgjegjëse e caktuar sipas paragrafit 3 të nenit 14 të këtij ligji, krijon dhe administron regjistrin e GVV.
2. Regjistri i GVV do të identifikojë GVV për çdo zonë, duke ofruar të paktën të dhëna mbi:
 - a. Zonën LEADER ku funksionon GVV;
 - b. Strukturën e GVV;
 - c. Statutin dhe Aktin e Themelimit të GVV;
 - d. Rregulloren e brendshme të GVV;
 - e. Aktivitetet vjetore të GVV;
 - f. Auditin dhe raportimin në GVV.
3. Pas procesit të akreditimit, sipas nenit 14 të këtij ligji, struktura përgjegjëse në ministri do të regjistrojë GVV e akredituara për çdo zonë, në regjistrin e GVV.
4. Në rast të mos-përbushjes së kërkesave të paragrafit 2 të këtij neni, struktura përgjegjëse për regjistrin e GVV do të njoftojë GVV përkatëse mbi këtë mos-përbushje dhe nëse kërkesat nuk arrihen brenda gjashtë muajsh do ta çregjistrojë atë GVV dhe do të procedojë me një regjistrim të ri GVV-je në atë zonë LEADER.
5. Rregullat dhe procedurat e detajuara për krijimin dhe administrimin e regjistrit do të aprovohen me urdhër të ministrit.

NENI 16 **Monitorimi dhe Vlerësimi i GVV**

1. Struktura përgjegjëse në ministri, e përcaktuar sipas paragrafit 3 të nenit 14 të këtij Ligji, monitoron dhe vlerëson në baza vjetore aktivitetin e GVV dhe përbushjen nga ana e tyre të parimeve dhe kriterëve të këtij ligji dhe do të ofrojë sugjerime/rekomandime kur i konsideron të nevojshme.
2. Rregullat dhe procedurat për monitorimin dhe vlerësimin e aktivitetit të GVV dhe përbushjes nga ana e tyre të parimeve dhe kriterëve të këtij ligji do të miratohen me urdhër të ministrit.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

NENI 17
Akte nën-ligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 12 muajsh, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të paragrafit 2 të nenit 14 të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural, që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e paragrafit 3 të nenit 14, paragrafit 5 të nenit 15 dhe paragrafit 2 të nenit 16 të këtij ligji.

NENI 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.